



International
Partnerships
Austria



Komentari i Buxhetit të Shtetit 2026 për Shqipërinë nën këndvështrimin gjinor





**International
Partnerships
Austria**



Ky dokument u përgatit si pjesë e Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetit Gjinor (GBWN). GBWN është një rrjet global me mbi 100 organizata të shoqërisë civile që punojnë për të forcuar llogaridhënien, transparencën dhe financat publike të përgjigjshme ndaj gjinisë. Dokumenti u përgatit me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Suedisë. Pikëpamjet e shprehura janë ato të autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA-s ose Suedisë.





Përmbledhje Ekzekutive

Buxheti i Shtetit për vitin 2026 përfaqëson një vazhdimësi të qasjes së qeverisë shqiptare drejt konsolidimit fiskal, stabilitetit makroekonomik dhe përsheptimit të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Projektbuxheti mbështetet në një parashikim të rritjes ekonomike rreth 4%, një deficit buxhetor të planifikuar në nivelin 2.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe një trajektore rënëse të borxhit publik, i cili pritet të ulet në rreth 53.6% të PBB-së në vitin 2026. Në terma makroekonomikë, kuadri fiskal paraqitet i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm.

Nga perspektiva gjinore, buxheti 2026 shënon një rritje të lehtë, por domethënëse, të peshës së buxhetimit të ndjeshëm gjinor. Sipas të dhënave zyrtare të buxhetit, rreth 9.5% e shpenzimeve buxhetore janë të dedikuara për politika publike me bazë gjinore, të shpërndara në rreth 85 programe buxhetore. Kjo shifër përfaqëson një rritje krahasuar me vitet e mëparshme (9.3% në 2024 dhe 9.1% në 2025), duke reflektuar një institucionalizim gradual të konceptit të buxhetimit gjinor në nivel formal. Buxheti 2026 paraqet këto politika si instrumente për reduktimin e pabarazive gjinore dhe për forcimin e pjesëmarrjes së grave në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Megjithatë, ashtu si në buxhetet e mëparshme, ky progres mbetet kryesisht deklarativ. Nuk ekzistojnë raporte vjetore vlerësimi që të dëshmojnë se si këto fonde janë shpërndarë në praktikë, cilat kategori grash dhe vajzash kanë përfituar realisht dhe çfarë ndikimi konkret kanë pasur politikat buxhetore në reduktimin e pabarazive gjinore. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë, indikatorëve të matshëm dhe mekanizmave të strukturuar të monitorimit dobëson ndjeshëm transparencën, llogaridhënien publike dhe besueshmërinë e angazhimeve gjinore të buxhetit.

Në këtë kontekst, edhe pse buxheti 2026 reflekton ambicie për zhvillim ekonomik dhe përfshirje sociale, barazia gjinore vijon të trajtohet më shumë si një objektiv sektorial sesa si një parim horizontal i integruar në të gjithë ciklin e politikave publike dhe buxhetore.

Pavarësisht këtyre ndërhyrjeve konkrete, mungesa e raportimit sistematik të rezultateve sipas gjinisë kufizon aftësinë për të vlerësuar nëse këto investime kontribuojnë realisht në reduktimin e pabarazive gjinore.

Në këtë drejtim, integrimi më i plotë i perspektivës gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit mbetet thelbësor për të siguruar që rritja ekonomike të përkthehet në mënyrë të barabartë në përfitime për gratë dhe burrat.



Konteksti Makroekonomik dhe Fiskal

Të ardhurat totale buxhetore për vitin 2026 parashikohen në rreth 823.1 miliardë lekë, ose 29.6% e PBB-së, ndërsa shpenzimet totale arrijnë në rreth 886.8 miliardë lekë, ose 31.9% e PBB-së. Si rezultat, deficitit buxhetor parashikohet në nivelin rreth 63.7 miliardë lekë. Politika fiskale vijon të orientohet drejt ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë dhe respektimit të rregullit fiskal për balancën primare.

Ky stabilitet makrofiskal krijon potencial real për përdorimin më strategjik të burimeve publike në adresimin e pabarazive sociale dhe gjinore. Megjithatë, dokumentet buxhetore nuk ofrojnë një analizë të qartë mbi mënyrën se si rritja e shpenzimeve dhe investimeve publike do të ndikojë në mënyrë të diferencuar gratë dhe burrat, duke kufizuar vlerësimin e drejtësisë shpërndarëse të buxhetit.

Konteksti Demografik dhe Tregu i Punës nga Perspektiva Gjinore

Të dhënat demografike konfirmojnë se gratë dhe vajzat përbëjnë mbi gjysmën e popullsisë së Shqipërisë. Jetëgjatësia mesatare për gratë vijon të jetë më e lartë se ajo e burrave, ndërsa pjesëmarrja e grave në tregun e punës mbetet dukshëm më e ulët. Sipas të dhënave zyrtare, shkalla e punësimit për gratë është rreth 62.6%, krahasuar me 75.7% për burrat, duke reflektuar një hendek të konsiderueshëm gjinor në tregun e punës.

Ky hendek gjinor reflekton barriera strukturore të qëndrueshme, si barra disproporcionale e punës së papaguar të kujdesit, mungesa e shërbimeve mbështetëse dhe segregimi gjinor në tregun e punës. Hendeku gjinor në paga mbetet i pranishëm, por mungesa e të dhënave të detajuara sipas sektorëve, profesioneve dhe rajoneve e bën të vështirë matjen e tij të saktë.

Në mungesë të politikave aktive, gjithëpërfshirëse dhe të mirëtargetuara për punësimin e grave veçanërisht për gratë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara dhe ato nga komunitetet e marginalizuara ekziston rreziku real që pabarazitë ekzistuese të riprodhohen dhe të thellohen më tej.

Buxhetimi i Ndjeshëm Gjinor në vitin 2026

Sipas dokumenteve zyrtare, buxheti 2026 parashikon që rreth 9.5% e shpenzimeve publike t'i dedikohen politikave me ndjeshmëri gjinore, kryesisht në sektorët e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Megjithatë, metodologjia për identifikimin e këtyre shpenzimeve mbetet e paqartë dhe kriteret për klasifikimin e programeve si "gjinore" nuk janë të publikuara.



Në mungesë të një kornize kombëtare të monitorimit dhe raportimit gjinor, buxheti i ndjeshëm gjinor mbetet i fragmentuar dhe i orientuar më shumë drejt inputeve financiare sesa drejt rezultateve dhe impaktit të matshëm në jetën e grave dhe vajzave.

Mbrojtja Sociale dhe Pensionet

Në terma absolutë, buxheti i sigurimeve shoqërore arrin në rreth 195.3 miliardë lekë, ndërsa buxheti i sigurimeve shëndetësore në rreth 67.3 miliardë lekë, duke konfirmuar se mbrojtja sociale dhe shëndetësia përfaqësojnë ndër sektorët më të rëndësishëm për mirëqenien ekonomike dhe sociale të grave.

Ky buxhet përfshin fondet për indeksimin e pensioneve dhe bonusin e pensionistëve, ndërkohë që qeveria ka deklaruar objektivin për rritjen graduale të pensionit minimal dhe atij mesatar në terma afatmesëm.

Nga këndvështrimi gjinor, këto masa janë veçanërisht të rëndësishme, pasi gratë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përfituesve nga skemat e pensioneve dhe janë më të ekspozuara ndaj varfërisë në moshë të thyer, për shkak të pagave më të ulëta dhe ndërprerjeve në karrierë. Për më tepër, programet e mbrojtjes sociale përfshijnë masa të targetuara për gratë në situata vulnerabël. Sipas të dhënave zyrtare të buxhetit 2026, rreth 61,000 familje përfitojnë nga ndihma ekonomike, ku rreth 40% e përfituesve janë gra viktime të dhunës në familje. Gjithashtu, rreth 8,300 gra përfitojnë nga mbështetja me kontribute shoqërore, me një fond prej rreth 850 milionë lekë, ndërsa rreth 2,000 gra dhe vajza përfitojnë nga programet e strehimit social. Programi i strehimit parashikon gjithashtu bonus qiraje për rreth 1,900 familje përfituese, si pjesë e politikave për mbështetjen e familjeve vulnerabël dhe përmirësimin e aksesit në strehim të përbalueshëm, ku një pjesë e konsiderueshme e përfituesve janë gra dhe familje me kryefamiljare gra. Këto masa synojnë të përmirësojnë sigurinë ekonomike dhe përfshirjen sociale të grave në situata të vështira socio-ekonomike. Përveç kësaj, buxheti parashikon mbështetje për rreth 94,000 përfitues me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre, si dhe 780,000 përfitues të skemave të pensioneve, duke reflektuar rëndësinë e mbrojtjes sociale në sigurimin e të ardhurave për grupet vulnerabël, përfshirë një numër të madh grash.

Gjithashtu, buxheti parashikon pagesa për barrë lindje për rreth 14,329 nëna ose baballarë, me një fond prej rreth 6.1 miliardë lekë, duke mbështetur sigurinë ekonomike të familjeve gjatë periudhës së lindjes së fëmijës. Kjo masë ka rëndësi të veçantë nga perspektiva gjinore, pasi kontribuon në mbështetjen e grave gjatë periudhës së maternitetit dhe në lehtësimin e barrës ekonomike të kujdesit për fëmijët.



Në të njëjtën kohë, mungesa e të dhënave të detajuara sipas gjinisë mbi nivelin e përfitimeve dhe ndikimin e tyre afatgjatë kufizon vlerësimin e efektivitetit të këtyre programeve në reduktimin e varfërisë gjinore.

Pagat, Punësimi dhe Ekonomia e Kujdesit

Buxheti 2026 parashikon vijimin e politikës së re të pagave, përfshirë rritjen e pagës minimale dhe indeksimin e pagave në administratën publike. Rritja e pagës minimale në 50,000 lekë në muaj dhe rritja e pagave në sektorin publik pritet të kenë ndikim pozitiv veçanërisht për gratë, të cilat janë të mbipërfaqësuar në sektorët publikë si arsimi, shëndetësia dhe shërbimet sociale.

Megjithatë, mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë për përfituesit e këtyre rritjeve e bën të pamundur vlerësimin e ndikimit real në ngushtimin e hendekut gjinor në paga. Për më tepër, buxheti nuk adreson në mënyrë eksplicite ekonominë e kujdesit dhe punën e papaguar, e cila vijon të mbetet një barrë strukturore kryesisht për gratë dhe një pengesë serioze për pjesëmarrjen e tyre në tregun formal të punës.

Investimet në shërbimet e kujdesit për fëmijët, si çerdhet dhe kopshtet, mbeten një komponent thelbësor për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, pasi mungesa e këtyre shërbimeve përbën një nga barrierat kryesore për punësimin e grave.

Megjithatë, buxheti nuk ofron një analizë të qartë mbi nivelin e investimeve në infrastrukturën e kujdesit për fëmijët dhe ndikimin e tyre në rritjen e punësimit të grave.

Shëndetësia 2026 – Qasje Gjinore dhe Sigurime Shëndetësore

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2026 parashikohet në rreth 67.3 miliardë lekë, me transferime të konsiderueshme nga buxheti i shtetit. Politikat shëndetësore fokusohen në shërbimet bazë, spitalore dhe rimbursimin e medikamenteve.

Gratë janë përdoruese kryesore të shërbimeve shëndetësore gjatë gjithë ciklit jetësor. Programet e depistimit për kancerin e gjirit dhe atë të qafës së mitrës vijnë të jenë pjesë e prioritetëve shëndetësorë, por mbulimi mbetet i kufizuar krahasuar me nevojat reale të popullsisë femërore. Programet shëndetësore parashikojnë gjithashtu depistimin e kancerit të gjirit për rreth 5,000 gra në vit, depistimin e kancerit të qafës së mitrës për rreth 12,500 gra në vit, si dhe financimin e ndërhyrjes për rikonstrukcionin e gjirit për rreth 350 gra në vit. Këto masa përfaqësojnë ndërhyrje të drejtpërdrejta për përmirësimin e shëndetit të grave dhe reduktimin e rreziqeve shëndetësore specifike gjinore.



Gjithashtu, mungesa e të dhënave të detajuara mbi mbulimin real të grave nga skemat e sigurimeve shëndetësore kufizon vlerësimin e aksesit të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore.

Në të njëjtën kohë, mungojnë programe të dedikuara për shëndetin mendor me ndjeshmëri gjinore, pavarësisht rritjes së rasteve të ankthit, depresionit dhe traumës, veçanërisht te gratë viktimat të dhunës në familje dhe gratë në situata vulnerabël socio-ekonomike. Po ashtu, nuk ka analiza të detajuara mbi aksesin real të grave në shërbime, egjiptiane, me aftësi të kufizuara apo që jetojnë në zona të thella rurale në shërbimet shëndetësore.

Arsimi dhe Formimi Profesional

Arsimi mbetet një sektor prioritar edhe në buxhetin 2026, si në aspektin e investimeve infrastrukturore, ashtu edhe të politikave të pagave për stafin arsimor. Gratë përbëjnë shumicën e mësuesve, veçanërisht në arsimin parashkollor dhe fillor.

Megjithatë, buxheti nuk adreson në mënyrë të qartë pabarazitë gjinore në zhvillimin e karrierës, aksesin në pozicione drejtuese dhe kushtet e punës në sistemin arsimor. Po ashtu, mungojnë të dhëna mbi ndikimin gjinor të investimeve në infrastrukturën shkollore, veçanërisht në zonat rurale, ku vajzat përballen me rreziqe më të larta të braktisjes shkollore.

Programet e formimit profesional vazhdojnë të jenë të orientuara drejt kërkesave të tregut të punës, por mungojnë të dhëna të qarta mbi përfshirjen e grave dhe rezultatet konkrete në punësim të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst, sipas të dhënave zyrtare të buxhetit 2026, programet e nxitjes së punësimit parashikojnë që rreth 744 gra dhe vajza të përfitojnë drejtpërdrejt nga programet e punësimit, ndërsa rreth 7,900 individë do të trajnohen në qendrat publike të formimit profesional. Këto masa synojnë të rrisin aftësimin profesional dhe të kontribuojnë në rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.

Gjithashtu, mungesa e të dhënave mbi shkallën e punësimit pas përfundimit të këtyre programeve kufizon vlerësimin e efektivitetit të tyre në integrimin afatgjatë të grave në tregun e punës.

Buxheti Vendor, Transfertat dhe Barazia Gjinore

Shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2026 parashikohen në rreth 97.7 miliardë lekë, ose 3.52% e PBB-së. Transferta e pakushtëzuar arrin në rreth 47.3 miliardë lekë, duke përfshirë



pjesën e përgjithshme, sektoriale, fondin për kompensimin e pagave dhe grantin e performancës.

Pavarësisht rritjes së fondeve, nuk ekziston një detyrim i qartë ligjor apo administrativ që bashkitë të aplikojnë buxhetim të ndjeshëm gjinor ose analiza të ndikimit gjinor. Duke qenë se shumë shërbime sociale ofrohen në nivel vendor, kjo përbën një mundësi të humbur për avancimin e barazisë gjinore në nivel komuniteti.

Megjithatë, mungesa e kërkesave të detyrueshme për raportim gjinor në nivel vendor kufizon transparencën dhe vlerësimin e ndikimit të shpenzimeve publike në barazinë gjinore në nivel lokal.

Shpenzimet sipas Funksioneve të Qeverisë (COFOG)

Analiza e shpenzimeve sipas funksioneve të qeverisë (COFOG) për vitin 2026 tregon se mbrojtja sociale, shëndetësia dhe arsimi zënë peshën më të madhe të shpenzimeve publike. Këta sektorë kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe disproporcional mbi gratë.

Megjithatë, mungesa e analizave gjinore në nivel COFOG e bën të pamundur vlerësimin e drejtësisë shpërndarëse dhe të efektivitetit të shpenzimeve nga perspektiva e barazisë gjinore.

Gratë në Zonat Rurale, Bujqësia dhe Zhvillimi Lokal

Buxheti 2026 parashikon mbështetje të kufizuar për gratë në bujqësi dhe zhvillimin rural, kryesisht përmes shërbimeve këshilluese dhe projekteve të vogla zhvillimore. Numri i grave përfituese mbetet i ulët në raport me rolin real të grave në ekonominë rurale. Në këtë kuadër, buxheti parashikon që rreth 540 gra të përfitojnë nga shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor, me një fond prej rreth 2.5 milionë lekë, duke synuar rritjen e kapaciteteve të grave fermere dhe përfshirjen e tyre më aktive në zhvillimin rural. Megjithatë, numri i përfituesve mbetet relativisht i kufizuar në raport me përmasën e pjesëmarrjes së grave në sektorin bujqësor në nivel kombëtar.

Gratë në zonat rurale përballen me barriera strukturore të vazhdueshme, përfshirë mungesën e pronësisë mbi tokën, akses të kufizuar në financa dhe tregje, si dhe barrë të lartë të punës së papaguar të kujdesit. Politikat buxhetore aktuale nuk adresojnë këto problematika në mënyrë sistematike dhe afatgjatë.



Investimet Publike, Infrastrukturat dhe Partneritetet Publike-Private

Investimet publike për vitin 2026 mbeten në nivele të larta, në përputhje me prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe rajonal. Megjithatë, planifikimi dhe zbatimi i projekteve infrastrukturore nuk shoqërohet me analiza të ndikimit gjinor. Po ashtu, mungesa e të dhënave mbi përfshirjen e grave në projektet e investimeve publike dhe në punësimin e lidhur me këto projekte kufizon vlerësimin e ndikimit të tyre në fuqizimin ekonomik të grave.

Partneritetet Publike-Private (PPP) dhe kontratat koncesionare vijnë të përdoren si instrumente financimi dhe ofrimi shërbimesh, por mungon një vlerësim sistematik mbi ndikimin e tyre social dhe gjinor, veçanërisht në lidhje me aksesueshmërinë, tarifatat dhe cilësinë e shërbimeve për gratë dhe grupet vulnerabël.

Konkluzione Përfundimtare

Buxheti i Shtetit 2026 ofron stabilitet makroekonomik dhe vijimësi në politikat fiskale dhe sociale. Nga perspektiva gjinore, vërehet një përmirësim gradual në nivel formal, por një mungesë e qartë e mekanizmave që do ta përkthenin këtë angazhim në rezultate konkrete dhe të matshme. Megjithatë, buxheti përfshin masa konkrete që targetojnë drejtpërdrejt gratë në fushat e punësimit, mbrojtjes sociale dhe shëndetësisë, mungesa e analizave gjithëpërfshirëse gjinore kufizon vlerësimin e efektivitetit të këtyre politikave në reduktimin e pabarazive.

Pa integrimin e barazisë gjinore si parim horizontal në të gjithë ciklin buxhetor, nga planifikimi dhe zbatimi, te monitorimi dhe vlerësimi, pabarazitë ekzistuese rrezikojnë të vazhdojnë dhe të thellohen.

Në mungesë të një integrimi të plotë dhe sistematik të perspektivës gjinore, ekziston rreziku që përfitimet e rritjes ekonomike të shpërndahen në mënyrë të pabarabartë ndërmjet grave dhe burrave.

Rekomandime Përfundimtare

- Institucionalizimi i buxhetimit të ndjeshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor.
- Vendosja e indikatorëve gjinorë të matshëm dhe raportim vjetor publik mbi rezultatet.
- Integrimi i analizës gjinore në shpenzimet COFOG, investimet publike dhe PPP-të.
- Forcimi i kapaciteteve të pushtetit vendor për planifikim dhe monitorim gjinor.
- Zhvillimi i politikave të dedikuara për ekonominë e kujdesit, shëndetin mendor dhe fuqizimin ekonomik të grave rurale.